Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës.Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**Afatet e realizimit të punimeve:**

<i>1</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>									
Nr	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6	Muaji 7	Muaji 8	Muaji 9	Muaji 10
1.										
2.										
3.										
4.										

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022**, ku vlera e xhiros për 3 (tre) vitet e fundit duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.
- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021, dhe 2022**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.
- 2.2.3 Vërtetim lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin **2023** për adresën ku operatori ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 (Përvoja të mëparshme)

-
- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **100%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën emëparshme kërkon :
 - i.** Kontratën e Sipërmarrjes,
 - ii.** Situacionin përfundimtar të objektit
 - iii.** Aktin e Kolaudimit të objektit
 - iv.** Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

- b) Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën emëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor

Kontrata të ngjashme konsiderohen të vlefshme nëse zërat kryesore të punimeve kanë volume të konsiderueshme krahasimorë të përcaktuara në këtë prokurim.

***Pika a)** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika b)** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjessë tyre në bashkim.*

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë emëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NP-1 – Klasifikimi B**
 - **Kategoria NP-4 – Klasifikimi D**
 - **Kategoria NP-12 – Klasifikimi C**

- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NS-4 – Klasifikimi C**
 - **Kategoria NS-18 – Klasifikimi B**

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatoriekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit te Cilesise)**
- **ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)**

- **ISO 50001:2011 (Sistem i Menaxhimit te Energjise)**
- **ISO 45001:2018 (Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune)**
- **ISO 27001:2013 ose ekuivalenti i tij (Sistemi i menaxhimit të sigurise se informacionit).**

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomikë, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **100 (njqind) punonjës** me kohe te plote pune për periudhën e fundit **5 (pesë) mujore** nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafii menaxherial i Drejtuesve Teknik. **Për vërtetimin e këtij kushti të paraqiten:**

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafinkryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar si drejtues Teknik në stafin e tij për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafin inxhinierik si më poshtë:
 - 1 (nje) **Inxhinier Ndërtimi Infrastruktura Transporti**
 - 1 (nje) **Inxhinier Ndërtimi**
 - 1 (nje) **Inxhinier Mekanik**
 - 1 (një) **Inxhinier Gjeoded (Topograf)**
 - 1 (nje) **Inxhinier Hidroteknik**
 - 1 (një) **Inxhinier Mjedisi**
 - 1 (një) **Inxhinier Gjeoteknik**
 - 1 (nje) **Arkitekt**
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kritereve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3-muajt e fundit.

b) Stafi mbeshtetes Operatori ekonomik duhet të ketë të të disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si : Dëshmi profesionale te punonjesve ose ekuivalent te tij/saj , punonjësit e meposhtem me specialitetin si dhe te figurojn ne listpagesat e shoqerise sipas pikes mesiperme (2.3.4) :

- 1 (nje) **Inxhinier Infrastruktore Transporti** (Diplome e shkolles se larte)
- 1 (nje) **Inxhinier Topograf** (Diplome e shkolles mesme)
- 3 (tre) **Teknik i mesem Ndërtimi** (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (nje) **Teknik i mesem Topograf** (Diplome e shkolles mesme)

- 1 (një) **Teknik i mesem Mekanik** (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (një) **Teknik i mesem Elektroteknik** (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (një) **Teknik i mesem Gjeometer** (Diplome e shkolles mesme)
- 1 (një) **Teknik i mesem Termohidralik** (Diplome e shkolles mesme)

- 6 (gjashte) **Murator** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 10 (dhjete) **Saldator** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 10 (dhjete) **Karpentier** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 5 (pese) **Gurthyes** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) **Elektracist** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 5 (pese) **Pllakashtrues** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 15 (pesembedhjete) **Punetor Asfalti** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) **Elektracist** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 10 (dhjete) **Hekurkthyes** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 2 (dy) **Punonjes Punime Mekanike** (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- 1 (një) **Mjek**

* Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje dokumentacionin që verteton profesionin si :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme
- Per stafin e mesiperm, Deshmia e kualifikimit/ certificate dhe/ose diploma e cila te jete e leshuar nga Ministria e Financave ose te njihet nga Ministria e Punes Ceshtjeve Sociale të paraqitet certificate/diploma profesionale per secilin. Certificatekat / diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “*Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.*”, i ndryshuar. Kjo kerkese po ashtu eshte ne perputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik. Diplomat/certificatekat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licensuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.
- Per manovraret dhe shoferet duhet te paraqiten dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “*Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi përdorimit të tyre*”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.
- **Certificate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise**
- **Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional (publik/privat) të akredituar sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa.**
- **Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:**

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marredhenieve të punës	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data e vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	---	---	------------------------------------	--

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i **ndryshuar**, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”*.

- c) Operatori Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”, i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë. Per kte te paraqitet Kontrate Pune (e vlefshme) dhe certifikata nga institucioni perkates

Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: *“2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimevetë mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Eficencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”*.

Shenim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

- d) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi të lëshuar nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë përperiudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, punonjës me specialitetin si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”** nga kryqi i kuq ose organe te akredituar te njohur nga Republika eShqiperise.
 - Minimuni **1 (nje) persona** që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** leshuar nga organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqiperise.
 - Minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë **“Kordinator i Sigurise”** të certifikuar te cilat duhet te jene leshuar nga organe te akredituar te njohur nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise
 - Minimuni **1 (nje) person** që përmbush kriteret për të qenë **“Pergjegjes per mbrojtjen dhe menaxhimin e demeve ne mjedis”**
 - Minimuni **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë **“Ekspert Zjarrfikës i pajisur me Licence I.2.A në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certificate/dëshmi per ekspert zjarrfikës te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noterialee punes.”**
 - Minimumi **1 (nje) person** të certifikuar për **“Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis”** te cilat duhet te jene leshuar nga organe te akredituar te njohur nga Ministria e Mjedisit.
 - Minimumi **1 (nje) inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore**, i certifikuar sipas VKM nr 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e. Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore” dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurise rrugore”.
- e) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë dhe vetë Drejtuesi Teknik) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) Librezë pune (përkatëse)
 - b) CV EU format përkatëse
 - c) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
 - d) Diplomë

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar minimumi **6 (shofer)** shofer kamionash me CAP dhe **8 (tete)** Manovrator me DAP dhe **2 (dy)** Buldozerist me DAP, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, **dhe për secilin të paraqiten:**

- a. Kontratë pune të vlefshme,
- b. Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,

2.3.7 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

a. Pllaka Troturari betoni, Bordura betoni, Tombino betoni.

Kontrate noteriale prodhuesi ose distributori te autorizuar, leje mjedisore kodi KODI III.1.B Leje Mjedisi Tipi B per Perzierja e cimentos ose perdorimi i cimentos ne mase te madhe por jo ne sheshin e ndertimit, perfshire ambalazhimin dhe perzierjen e cimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos, si dhe KODI III.1.A Autorizim mjedisor për projektin: "Prodhime elemente betoni dhe materiale ndërtimi"), **Fabrika ose Distributori te jete jo me larg se 50 km nga objekti.** eshte kerkuar largesia 50 km per faktin se duke mare parasysh terrenin malor te objektit si dhe kohen e fillimit te ngurtesimit te betonit,ka kushte te vecanta per transportin e betonit,kjo mbeshtetur dhe ne KTZ-81 dhe Vendimin nr.679, datë 22.10.2004 për Miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore.ku thuhet: Humbja e puneshmërisë është një fenomen që vihet re në orën e parë ose maksimumi në dy orët e para nga momenti i prodhimit të betonit. Transporti është faktor shumë i rëndësishëm i cili ka ndikim të madh mbi cilësinë e betonit. Elementet themelore në bazë të cilëve planifikohet transporti janë: lidhja e parakohshme dhe segregacioni i betonit. Përveç kësaj, transporti duhet të jetë i shpejtë, racional,të sigurojë mbrojtje nga avullimi i ujit, rrjedhja e qumështit të çimentos etj.. Koha maksimale orientuese për transport është Temperatura e betonit të freskët°C 5-10, 10-20 ,20-30 Koha maksimale për transport (min) 120 ,90, 45

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim). Gjithashtu O.E. te paraqes deklarate garancie jo me pak se 1 vit nga momenti i marrjes nedorezim.

b. Tubo HDPE dhe PVC.

Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi I produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi I plastikes) dhe certifikatëne cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet dhe kontrata paraprake noteriale e furnizimit evlefshme.

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim).

Gjithashtu O.E. te paraqes deklarate garancie jo me pak se 1 vit nga momenti i marrjes ne dorezim.

c. Boje per vijezimet pasjisur me certifikatat e cilesise dhe Raport Testimi

- d.** Shtylla Elektrike, Ndricues LED, Elektroda, Kabell Kabell 0,6/1 KV ; tip RG7R ; 4x10mm² & Kabell 0,6/1 KV ; tip RG7R ; 3x1,5mm² Shoqeruar me certifikat cilesie

- e.** Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019”

Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL kodi III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme” dhe III.2.B “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të ujrave të ndotura urbane, llumrave septike dhe ujrave të zeza.

2.3.8 (Makineri, Pajisje)

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Mjetet	Sasia	Pronësia
Kamion me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	10 cope	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes 10-17 ton	7 cope	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes 10-15 ton	3 cope	Pronësi ose me qera
Kamion 8 ton min deri ne 10 ton max	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me viç min 6 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes 3.5 ton min – 5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes 2.5 ton min – 3 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes 1.5 ton min – 2 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes 1 ton min – 3 ton max	2 copë	Pronësi ose me qera
Koke terheqese	2 cope	Pronësi ose me qera
Rimorkio me kapacitet mbajtes mbi 70 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rimorkio me kapacitet mbajtes mbi 30 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc me pesh ngritese 60 ton per levizjen e tubave te celikut dhe tombinove	1 cope	Pronësi ose me qera
Rul Gome – Hekur mbi 18 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Rul Gome hekur mbi 14 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul Gome Hekur 8-10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rul asfalti hekur hekur 1-3 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul hekur hekur mbi 8 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	8 copë	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	5 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	3 copë	Pronësi ose me qera
Grejder me targa	2 copë	Pronësi ose me qera
Dumper me goma me targa	2 copë	Pronësi ose me qera

Minifafrome me goma me targa	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	4 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji me kapacitet min 15,000 litra	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me kove 1 m ³	3 copë	Pronësi ose me qera
Buldozer	2 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	2 copë	Pronësi ose me qera
Fshese Asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri Vijezi	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri per vendosjen e guarderilave	1 copë	Pronësi ose me qera
Germues i superstruktures me rrotullim 360	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadroma me goma me kove para dhe mbrapa	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc me kosh	3 copë	Pronësi ose me qera
Cekic pneumatik	2 copë	Pronësi ose me qera
Depozitë uji 5000 litra	2 copë	Pronësi ose me qera
Motopompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë zhytëse per ujra te ndotura me prurje >100 L / min	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat saldimi tub plastik me elektrofuzion 20 mm – 1200 mm	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat saldimi per ngjitje tub plastik kok me koke	1 copë	Pronësi ose me qera
Panele armature betoni	500 m ²	Pronësi ose me qera
GPS	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	4 copë	Pronësi ose me qera
Deflektometer	1 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak	2 copë	Pronësi ose me qera
Elektroorgan	1 copë	Pronësi ose me qera
Gazogjen	1 copë	Pronësi ose me qera
Prerëse asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Kalander per punimin e Metalit	1 copë	Pronësi ose me qera
Zmerilatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Nivelues me laser	1 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator 18 kva	1 cope	Pronësi ose me qera
Gjenerator 66 kva	1 cope	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera

Pompe uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	3 copë	Pronësi ose me qera
Nyje prodhimi inertesh e pajisur me Leje Mjedisi	1 copë	Në pronësi ose me qira /ose kontratë furnizimi III.1.B,IV.1.B,III.I.A

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër kërkuar**. Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:

- çertifikatën e pronësise;
- lejen e qarkullimit;
- çertifikatën e kontrollit teknik;
- siguracionin;

- certifikate transporti lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe fotot perkatese;

ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, nuk janë të angazhuara në procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.9 Operatorët ekonomikë, duhet të kenë 1 (një) gurore për veprimtari minerale për shfrytëzimin e llojit mineral gëqerorë, pllakor që bën pjesë në llojin e mineraleve ndërtimore, e cila duhet të jetë e pajisur me dokument pronësie dhe leje IV.1.B.2, shoqëruar me akt miratimit të lejeve lëshuar nga autoritetet e autorizuar me ligj. Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit.

2.3.10 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivitet perkates të publikuar në SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi.

- **Tombino betoni**

2.3.11 Operatorët ekonomik duhet të kenë Fabrike të prodhimit të elementeve të betonit - bordurave dhe pllakave duhet të jenë të pajisur me skemën teknologjike të makinerisë,

planvendosje, leje mjedisore nga QKL. Fabrike e prodhimit te elementeve te betonit - bordurave dhe pllakave.

- a) Per Fabriken e Asfalto-Betonit dhe Linjen e Prodimit te Materialeve Inerte duhet te paraqiten dokumentet e pronesis se akte çdoganimi ose fatura tatimore te blerjes, leja mjedisore e leshuar nga QKL kodi III.1.B + Akt-Miratimin, si dhe Planvendosje e vendodhjes se objektit e cila ne rastin e fabrikes se Asfalto-Betonit nuk duhet te jete ne distance me te madhe se 35 km nga objekti i prokurimit. Ne rastin e fabrikes/linjes me qera/kontrate furnizimi dokumentete e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Operatori ekonomik duhet te deklaroje vendodhjen e sakte te impiantit, te paraqese planin e vendosjes dhe fotografi te impiantit (referuar percaktimeve te VKM 628 DT 15.07.2015). Perjashtohen rastet kur Impianti eshte mobile (i levizshem). Ne kete rast operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin ligjor qe vereteton pronesine e tij (fature tatimore/zhdoganimi ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqeruar me foto).

2.3.12 Per Impiantin e prodhimit te asfaltobetonit duhet te paraqese Raport Vetemonitorimi planvendosjen dhe projektin teknologjik.

2.3.13 Per fabriken e Betonit operatori ekonomik duhet te paraqese Certificate Inspektimi/Kalibrimi.

2.3.14 Analizat e cmimeve per cdo ze te preventivit mosparaqitja e tyre perben shkak per skualifikim.

Sqarim per ofertuesit: Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020**

“Per Prokurimin Publik” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Sgarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021. **Në çdo rast, përpara se të publikoje njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.****

Të gjitha dokumentet duhet të jenë ne gjuhen shqipe , origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në çdo rast, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkoje kopjen origjinale të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ofertues. Rastet e mos-dorëzimit të dokumentacionit origjinal brenda afatit të kërkuar nga AK, konsiderohen si kusht për skualifikim.

Shtojca 8*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

propozuar				• infor maci on
mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik				
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et	

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara</p>

në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

